REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

# SKELETKURRIKULI

## Për Kualifikimin Profesional

# FRUTIKULTURË

## Niveli III i KSHK[1], referuar nivelit III të KEK[2]
**(1 vjeçar)**

**Kodi: H1-III-24**

**(Hartuar me mbështetjen e Projektit ProSEED 2.0 - GIZ)**

Miratoi:

MINISTRI

1.Korniza Shqiptare e Kualifikimit
2.Korniza Europiane e Kualifikimit

**Tiranë, 2025**

## Përmbajtja:

**I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor "Bujqësi".**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit profesionalnë kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit profesional të mëtejshëm në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.

**III. Plani mësimor për kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor.**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

**XI. Programi orientues i provimeve përfundimtare të nivelit.**

## I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK, të drejtimit "Bujqësi".

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK, është *"zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t'u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me sektorin e frutikulturës.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t'u njohur me rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t'i zbatuar ato me përpikmëri;
- mbështetje për t'u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t'u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.

### 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë" niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në kualifikimin profesional"Bujqësi", niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë, Ministria përgjegjëse e AFP-së përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;

- Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara;
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik;

## 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të bëjë planifikimin dhe organizimin e punës në frutikulturë.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të vlerësojë kushtet mjedisore të fermës për prodhimin në frutikulturë.
- Të prodhojë fidanë të shartuar të kulturave drufrutore dhe hardhisë.
- Të shartojë kulturat drufrutore dhe hardhitë.
- Të përcaktojë kultivarët kryesorë të pemëve frutore dhe hardhive.
- Të zbatojë teknologjitë e kultivimit në pemëtore dhe vreshta.
- Të zbatojë teknologjitë e kultivimit biologjik në pemëtore dhe vreshta.
- Të kryejë shërbimet agroteknike dhe vjeljen në pemëtore e vreshta.
- Të krasitë kulturat drufrutore dhe hardhitë.
- Të kontrollojë sëmundjet dhe dëmtuesit në pemtore e vreshta.
- Të kryejë përpunime të thjeshta të prodhimeve të pemëve frutore dhe rrushit.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet digjitale për matjen dhe regjistrimin e parametrave klimatiko-tokësorë dhe sensorëve digjitalë për monitorimin e tyre.
- Të zbatojë teknikat e paketimit të produkteve frutore të përpunuara me ambalazhe ekologjike sipas standardeve;
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë kultivimit të pemëve frutore dhe vreshtave.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të komunikojë me etikë profesionale.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë e të mbrojtjes së mjedisit.
- Të zbatojë kushtet e higjienës dhe sigurisë gjatë veprimtarive në frutikulturë.

**III. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.**

Ky arsimim i jep mundësi individit t'i drejtohet tregut të punës, brenda dhe jashtë vendit, në frutikulturë: për prodhim fidanësh të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe hardhisë; për të shërbyer në pemëtoret e prodhimit; për të shërbyer në sektorin privat shtëpiak në zonat urbane dhe rurale; për vetëpunësim në fermën e tij vetjake.
Në përfundim të këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) për të fituar të drejtën e Diplomës së "Maturës Shtetërore Profesionale", me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.

## III. Plani mësimor për arsimin profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.

| Plani mësimor për kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr** | **Kodi** | **Lëndët dhe modulet mësimore** | **Orët javore/ vjetore** |
| | | | **Klasa 12** |
| **A.** | | **Lëndët e përgjithshme** (Gjithsej) | **8/9 (272/306)** |
| 1 | | Gjuhë shqipe | 1 |
| 2 | | Letërsi | 1 |
| | | Gjuhë e huaj e parë | 2 |
| 3 | | Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë) | (1) |
| 4 | | Matematikë | 2 |
| 5 | | Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK) | 1 |
| 6 | | Edukim fizik, sporte, shëndet | 1 |
| **B.** | | **Lëndët profesionale** (Gjithsej) | **7 (238)** |
| 1 | L-17-157-22 | Bazat e sipërmarrjes | 2 |
| 2 | L-14-172-24 | Frutikulturë | 3 |
| 3 | L-08-716-24 | Përpunimi i frutave dhe rrushit | 1 |
| 4 | L-14-717-24 | Teknologjitë e prodhimit biologjik në frutikulturë | 1 |
| **C.** | | **Module të detyruar të praktikës profesionale** (Gjithsej) | **12 (408)** |
| 1 | M-14-454-24 | Prodhimi i fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore | 69 |
| 2 | M-14-455-24 | Prodhimi i fidanëve të shartuar të hardhisë | 69 |
| 3 | M-08-2116-24 | Përpunime të prodhimeve frutore | 36 |
| 4 | M-14-2117-24 | Shërbimet agroteknike dhe vjelja në pemëtore e vreshta | 66 |
| 5 | M-14-458-24 | Shartimi në vend i kulturave drufrutore dhe hardhisë | 36 |
| 6 | M-14-459-24 | Krasitja e kulturave drufrutore | 60 |
| 7 | M-14-1593-24 | Krasitja e hardhisë | 36 |
| 8 | M-14-2118-24 | Vlerësimi i cilësive biologjike të tokës në frutikulturën | 36 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | biologjike | |
| **D.** | | **Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar** (Gjithsej) | **3 (102)** |
| 1 | M-08-2119-24 | Prodhimi artizanal i vajit të ullirit | 51 |
| 2 | M-14-462-24 | Prodhimi i fidanëve të shartuar të ullirit | 51 |
| 3 | M-14-463-24 | Prodhimi i fidanëve të shartuar të agrumeve | 51 |
| 4 | M-08-2120-24 | Kontrolli biologjik i dëmtuesve në pemëtore e vreshta | 51 |
| | | **Gjithsej A+B+C+D** | **30/31 (1020/ 1054)** |

## IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).
Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).
Një orë mësimore zgjat 45 minuta.
Kurrikuli i arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për profilet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin te ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.
E rëndësishme është që ***planifikimi i mësimdhënies*** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integrimit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.
Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.
Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i "të nxënit duke bërë" duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të kualifikimit profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.
Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj

jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.
Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të kualifikimin profesional "Frutikulturë" Niveli III i KSHK-së.

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.
Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:
a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;
Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e frutikulturës, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

## VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional "Frutikulturë", niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Certifikatën profesionale dhe Suplementin përkatës, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga Ministria përgjegjëse e AFP-së, këto dëshmi përmbajnë:
a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
b) Të dhëna për rezulatet e arrritura nga nxënësi:
- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale.
- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda "Bazat e sipërmarrjes" (L-17-157-22). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12, nxënësit duhet:
- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontektin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontektin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efiçiencë burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë mërrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12 - 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 2** | Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse | 3 orë |
| **Tema 3** | Vetëvlerësimi i potencialit personal | 3 orë |
| **Tema 4** | Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive | 4 orë |
| **Tema 5** | Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja | 4 orë |
| **Tema 6** | Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve | 3 orë |
| **Tema 7** | Etika e komunikimit dhe negocimit | 4 orë |
| **Tema 8** | Puna individuale dhe puna në grup | 4 orë |
| **Tema 9** | Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi | 3 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 10** | Përgjegjësia individuale dhe shoqërore | 3 orë |
| **Tema 11** | Menaxhimi efiçient i burimeve | 3 orë |
| **Tema 12** | Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 13** | Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale | 5 orë |
| **Tema 14** | Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale | 3 orë |
| **Tema 15** | Format e organizimit të sipërmarrjeve | 5 orë |
| **Tema 16** | Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj. | 6 orë |
| **Tema 17** | Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve | 5 orë |
| **Tema 18** | Marrëdhëniet e punës | 4 orë |

## 2. Lënda "Frutikulturë", (L-14-172-24). Kl. 12 – 102 orë

- **Synimet e lëndës "Frutikulturë", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Frutikulturë", kl.12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajë kultivarët kryesorë të pemëve frutore farore.
- Të përshkruajë kultivarët kryesorë të pemëve frutore bërthamore.
- Të përshkruajnë kultivarët e pemëve frutore arrore.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të fidanëve të pemëve frutore.
- Të përshkruajnë përzgjedhjen e kultivarëve të pemëve frutore sipas zonave klimatiko-tokësore.
- Të përshkruajnë faktorët klimatikë që ndikojnë në zhvillimin e pemëve frutore.
- Të përshkruajnë teknologjitë e kultivimit të pemëtoreve.
- Të përshkruajnë shërbimet agroteknike në pemëtore.
- Të përshkruajnë krasitjet formuese, prodhuese dhe ripërtëritëse në pemëtore dhe vreshta.
- Të listojë pajisjet digjitale për monitorimin e sasisë së ushqyesve për plehërimin dhe ujitjen e kulturave drufrutore dhe hardhive.
- Të përshkruajë metodat e kontrollit digjital të dëmtuesve të pemëve frutore dhe hardhisë.
- Të përshkruajnë teknologjitë e kultivimit të vreshtave.
- Të përshkruajnë faktorët klimatikë dhe tokësorë që ndikojnë në zhvillimin e hardhisë.
- Të përshkruajnë rajonizimin e hardhisë në vendin tonë.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të fidanëve të hardhive.
- Të shpjegojnë zhvillimin individual, ciklin vjetor të zhvillimit dhe mënyrat e shtimit të hardhisë.
- Të argumentojnë domosdoshmërinë e prodhimit të fidanëve antifilokserik.
- Të përshkruajnë parimet mbi të cilat mbështet ngritja e vreshtit mëmë antifilokserik.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të fidanave të shartuar antifilokserikë dhe shërbimet që u bëhen shartesave në shartesore.
- Të përshkruajë shërbimet agroteknike që kryhen në vreshta.
- Të përshkruajë kultivarët e rrushit për tavolinë.
- Të përshkruajë kultivarët e rrushit për prodhim vere dhe për tharje.
- Të përshkruajnë kultivarët e ullirit.
- Të përshkruajnë përzgjedhjen e kultivarëve të ullirit sipas zonave klimatiko-tokësore.
- Të përshkruajnë rrugët e shtimit e të ngritjes së një fidanishteje të ullirit.
- Të përshkruajnë mënyrat e shtimit me shartim te ulliri dhe prodhimin e fidanëve të rinj.
- Të përshkruajnë teknologjitë e kultivimit të ullirit.

- Të përshkruajë shërbimet agroteknike që kryhen në ullishte.
- Të përcaktojnë parimet bazë të krasitjes dhe format më të përshtatshme të krasitjes së ullirit (formuese, prodhuese, ripërtëritëse).
- Të përshkruajnë kultivarët kryesorë të agrumeve.
- Të përshkruajnë rrugët e shtimit e të ngritjes së një fidanishteje të agrumeve.
- Të përshkruajnë mënyrat e shtimit me shartim te agrumet dhe prodhimin e fidanëve të rinj.
- Të përcaktojnë parimet bazë të krasitjes dhe format më të përshtatshme të krasitjes së agrumeve (formuese, prodhuese, ripërtëritëse).
- Të përshkruajnë shërbimet agroteknike që kryhen në agrume.
- Të përcaktojnë kohën e vjeljes së frutave te kulturat drufrutore.
- Të përshkruajnë mënyrat e vjeljes dhe teknologjitë e pasvjeljes së frutave.
- Të përcaktojnë kushtet për ambalazhimin dhe ruajtjen e frutave të kulturave drufrutore.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Frutikulturë", kl 12 - 102 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Kultivarët kryesorë të pemëve frutore farore | 4 orë |
| **Tema 2** | Kultivarët kryesorë të pemëve frutore bërthamore | 6 orë |
| **Tema 3** | Kultivarët kryesorë të arroreve | 3 orë |
| **Tema 4** | Kultivarët kryesorë të pemëve të tjera frutore | 10 orë |
| **Tema 5** | Kultivarët kryesorë të hardhive | 7 orë |
| **Tema 6** | Teknologjitë e kultivimit të pemëtoreve | 10 orë |
| **Tema 7** | Teknologjitë e kultivimit të vreshtave | 6 orë |
| **Tema 8** | Përzgjedhja e kultivarëve të pemëve frutore dhe hardhive sipas zonave klimatiko-tokësore | 9 orë |
| **Tema 9** | Krasitjet formuese dhe prodhuese në pemëtore e vreshta | 9 orë |
| **Tema 10** | Shërbimet agroteknike në pemëtore e vreshta | 4 orë |
| **Tema 11** | Teknologjia e kultivimit të ullirit | 4 orë |
| **Tema 12** | Shërbimet agroteknike te ulliri | 10 orë |
| **Tema 13** | Kultivarët e ullirit | 2 orë |
| **Tema 14** | Teknologjia e kultivimit të agrumeve | 4 orë |
| **Tema 15** | Shërbimet agroteknike te agrumet | 10 orë |
| **Tema 16** | Kultivarët e agrumeve | 2 orë |
| **Tema 17** | Vjelja dhe teknologjitë e pasvjeljes së frutave | 2 orë |

## 3. Lënda "Përpunimi i frutave dhe rrushit" (L-08-716-24). Kl.12 – 34 orë

- **Synimet e lëndës "Përpunimi i frutave dhe rrushit", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Përpunimi i frutave dhe rrushit", kl.12, nxënësit duhet:
- Të theksojnë rëndësinë ekonomike të frutave të freskëta dhe të frutave të thata.
- Të përshkruajnë karakteristikat e frutave që do të përpunohen.
- Të theksojnë vlerat ushqyese të frutave.
- Të përcaktojnë përqindjet e sheqerit në fruta të ndryshme.
- Të klasifikojnë frutat për lloje të ndryshme të përpunimit si: lëngje, komposto, reçel, marmalatë e fruta të thata.
- Të dallojnë mjetet që përdoren për çdo proces përpunimi.
- Të shpjegojë mënyrat, materialet dhe teknikat e pastrimit të produkteve frutore.

- Të shpjegojë mënyrat e parapërgatitjes së lëndëve të para për përpunime të thjeshta.
- Të përshkruajë mënyrën e prodhimit të lëngjeve, kompostos, reçelit, marmelatës dhe prevedesë në fruta të ndryshëm.
- Të përshkruajnë kriteret dhe teknologjinë e prodhimit të kompostove.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të kompostos së mollës, dardhës, pjeshkës, kumbullës, qershisë, vishnjës etj.
- Të rendisin kriteret mbi të cilat bazohet prodhimi i reçelrave.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të reçelit të kumbullës, qershisë, pjeshkës, mollës, dardhës, fikut etj.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të reçelit të portokallit, qitros, nerënxës etj.
- Të rendisin kriteret mbi të cilat bazohet prodhimi i marmalatës.
- Të përshkruajnë prodhimin e marmalatës së mollës, dardhës, fikut etj.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të prodhimin e frutave të thata.
- Të rendisin kriteret mbi të cilat bazohet prodhimi i lëngjeve.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të lëngjeve të mollës, dardhës etj.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të lëngjeve të portokallit dhe të limonit.
- Të përshkruajnë karakteristikat e llojet e rrushit që do të përpunohet.
- Të theksojnë vlerat ushqyese, përqindjen e sheqerit dhe trajtat e tij, te rrushi për përpunim.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të rakisë.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të prevedes dhe lëngut të rrushit.
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së ullirit për ngrënie dhe teknikat për kriposje.
- Të shpjegojë llojet, teknikat e ambalazhimit dhe rëndësia e përdorimit të ambalazheve ekologjike.
- Të shpjegojë kushtet teknike për ruajtjen e produkteve të përpunuara.
- Të përshkruajë kushtet e higjienës dhe sigurisë gjatë përpunimit të prodhimeve frutore.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Përpunimi i frutave dhe rrushit", kl 12 - 34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Rëndësia e përdorimit dhe e përpunimit të thjeshtë të frutave. | 3 orë |
| **Tema 2** | Përpunimi i frutave të freskëta për lëng e komposto. | 4 orë |
| **Tema 3** | Përpunimi i frutave të freskëta për reçel, marmalatë dhe prevede. | 5 orë |
| **Tema 4** | Përpunimi i frutave të thata. | 3 orë |
| **Tema 5** | Përpunimi i rrushit të freskët. | 6 orë |
| **Tema 6** | Përpunimi i agrumeve. | 3 orë |
| **Tema 7** | Përpunimi i ullirit | 4 orë |
| **Tema 8** | Teknikat e ambalazhimit dhe përdorimi i ambalazheve ekologjike. | 2 orë |
| **Tema 9** | Kërkesat teknike për ruajtjen e produkteve të përpunuara. | 2 orë |
| **Tema 10** | Kushtet e higjienës dhe sigurisë gjatë përpunimit të prodhimeve frutore. | 2 orë |

## 4. Lënda " Teknologjitë e prodhimit biologjik në frutikulturë" (L-14-717-24). Kl. 12 – 34 orë

- **Synimet e lëndës " Teknologjitë e prodhimit biologjik në frutikulturë", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Teknologjitë e prodhimit biologjik në frutikulturë", kl.12, nxënësit duhet:
- Të vlerësojnë cilësinë biologjike të tokës sipas teknikave përkatëse;

- Të mbikëqyrin përgatitjen e tokës duke ruajtur mjedisin mikrobiologjik të saj sipas teknikave përkatëse;
- Të shpjegojnë mënyrat e punimeve të tokës, teknikat dhe mjetet e punimeve minimale;
- Të përzgjedhin fara dhe/apo fidanë me prejardhje organike sipas certifikatës së origjinës;
- Të mbikqyrin plehërimin organik të tokës sipas teknikave përkatëse;
- Të mbikëqyrin mbjelljen e farave dhe fidanëve sipas teknikave përkatëse;
- Të mbikëqyrin zbatimin e shërbimeve agroteknike sipas parametrave të kultivimit biologjik në frutikulturë;
- Të listojnë preparatet e lejuara për mbrojtjen e bimëve në bujqësinë biologjike në frutikulturë;
- Të listojnë platformat digjitale për kontrollin e dëmtuesve në frutikulturën biologjike;
- Të përshkruajnë llojet e ambalazheve ekologjike dhe teknikat e ambalazhimit;
- Të mbikëqyrin proceset e vjeljes së kulturave drufrutore biologjike sipas teknikave përkatëse;
- Të mbikëqyrin kushtet e ruajtjes së prodhimit të kulturave frutore biologjike sipas parametrave të kërkuar.
- Të përshkruajnë normat teknike të kontrollit, certifikimit dhe etiketimit të produkteve frutore biologjike;

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës " Teknologjitë e prodhimit biologjik në frutikulturë", kl.12 - 34 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Njohuri për ligjin shqiptar për bujqësinë biologjike dhe direktivën evropiane për bujqësinë organike | 2 orë |
| **Tema 2** | Normat teknike për prodhimin biologjik në frutikulturë | 3 orë |
| **Tema 3** | Metodat dhe teknikat e analizimit të cilësive biologjike të tokës | 2 orë |
| **Tema 4** | Llojet e plehrave, plehrat organike dhe minerale/shtuesit e lejuar në bujqësinë biologjike në frutikulturë | 3 orë |
| **Tema 5** | Tipet e punimeve të tokës dhe teknikat e punimeve minimale | 3 orë |
| **Tema 6** | Metodat dhe teknikat e analizimit të cilësive fiziko-kimike e biologjike të ujit | 3 orë |
| **Tema 7** | Metodat dhe teknikat e prodhimit biologjik të fidanëve në frutikulturë | 2 orë |
| **Tema 8** | Normat teknike të shërbimeve agroteknike në frutikulturën biologjike | 3 orë |
| **Tema 9** | Preparatet e lejuara për mbrojtjen e bimëve në frutikulturën biologjike | 2 orë |
| **Tema 10** | Platformat digjitale për kontrollin e dëmtuesve në frutikulturën biologjike | 3 orë |
| **Tema 11** | Teknikat dhe mjetet për vjeljen e produkteve frutore biologjike | 2 orë |
| **Tema 12** | Teknikat dhe metodat e manipulimit të produkteve frutore biologjike të pas vjeljes | 2 orë |
| **Tema 13** | Llojet e ambalazheve ekologjike, teknikat e ambalazhimit dhe ruajtjes së produkteve frutore biologjike | 2 orë |
| **Tema 14** | Normat teknike të kontrollit, certifikimit dhe etiketimit të produkteve frutore biologjike | 2 orë |

# IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

## 1. Moduli “Prodhimi i fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore”

**Kualifikimi:** **Frutikulturë**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PRODHIMI I FIDANËVE TË SHARTUAR TË KULTURAVE DRUFRUTORE** | **M-14-454-24** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për prodhimin e copave për nënshartesa, për të prodhuar fidanë dhe kryerjen e shartimit me syth të fjetur, kryerjen e shërbimeve të nevojshme, si dhe për llogaritjet e thjeshta ekonomike lidhur me prodhimin e fidanëve të kulturave drufrutore. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 69 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer Për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK. | |

**Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit**

**RN 1 Nxënësi/ja siguron copat për nënshartesa.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për sigurimin e copave për nënshartesa;
- të përgatitë vendin e punës për sigurimin e copave për nënshartesa;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e punës për sigurimin e copave për nënshartesa;
- të kontrollojë dhe përgatisë veglat dhe pajisjet dhe materialet për sigurimin e copave për nënshartesa;
- të përcaktojë nënshartesat për secilën kulturë drufrutore;
- të bëjë vlerësimin e copave që do të përdoren për nënshartesa;
- të pastrojë copat nga papastërtitë, sipas kritereve teknike;
- të bëjë prerjen e copave sipas standardeve teknike;
- të ruajë copat në rërë të pastër dhe të lagur;
- të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e copave;
- të përcaktojë fuqinë mbirëse të copave;
- të kujdeset dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e përdorura për sigurimin e copave për nënshartesa;
- të pastrojë dhe sistëmojë vendin pas sigurimit të copave nënshartesa;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale gjatë sigurimit të copave për nënshartesa;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të mbrojtjes së mjedisit

gjatë sigurimit të copave për nënshartesa;

***Instrumentet e vlerësimit:***

– Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2 Nxënësi/ja mbjell copat për prodhimin e filizave për nënshartesa.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

– të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
– të përgatitë vendin e punës për prodhimin e filizave për nënshartesa;
– të kontrollojë dhe përgatisë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për punë;
– të përzgjedhë veglat, mjetet dhe materialet e tjera për prodhimin e filizave për nënshartesa.
– të përzgjedhë vendin për ngritjen e farishtes sipas kritereve teknike.
– të përzgjedhë tokën për mbjelljen e copave për nënshartesa sipas kritereve teknike.
– të transportojë veglat, mjetet dhe materialet e tjera në vendin e përzgjedhur.
– të llogarisë distancat e mbjelljes në favor të mekanizimit.
– të piketojë rreshtat duke respektuar distancat e mbjelljes.
– të llogarisë sasinë e nevojshme të copave për mbjellje.
– të mbjellë në thellësinë e duhur copat për nënshartesa.
– të kryejë përkujdesjet pas mbirjes së copave sipas nevojës.
– të kryejë rrallimin e copave duke respektuar distancat e duhura.
– të kryejë zevëndësimin e filizave ku është e nevojshme.
– të kryejë shërbime të tjera si: ujitje, shkuljen e barërave të këqija, plehërime, pastrimi i pjesës fundore deri kur të bëhet shartimi.
– të kontrollojë shkallën e pjekurisë së filizave me teknikën e hapjen e lëvores nga druri.
– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë mbjelljes së copave për prodhimin e filizave për nënshartesa.
– të kujdeset dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e përdorura gjatë mbjelljes së copave për prodhimin e filizave për nënshartesa;
– të pastrojë dhe sistëmojë vendin gjatë mbjelljes së copave për prodhimin e filizave për nënshartesa;
– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së copave për prodhimin e filizave për nënshartesa.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësi/ja sharton filizat me syth të fjetur.**

***Kriteret e vlerësimit:***
Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për shatimin e filizave ne syth të fjetur;
- të organizojë vendin e punës për kryerjen e shartimit të filizave me syth të fjetur;
- të sigurojë veglat dhe materialet e nevojshme për kryerjen e shartimit me syth të fjetur;
- të kontrollojë dhe përgatisë veglat e shartimit për punë;
- të përcaktojë drejt radhën e punës për kryerjen e shartimit të filizave me syth të fjetur;
- të përcaktojë momentin e shartimit duke u nisur nga trashësia rreth 10 mm dhe lartësinë 15 cm nga toka;
- të sigurojë dhe ruajë mbishartesa, sipas kushteve të përcaktuara;
- të hapë lehtësisht lëkurën te nënshartesat;
- të kryejë prerje në formë "T-je" dhe të hapë lëvoren;
- të përzgjedhë kalemat e pjekur te mbishartesat për nxjerrjen e sythave;
- të nxjerrë sythin nga kalemat e mbishartesës, sipas procedurës përkatëse;
- të vendosë sythin në pjesën e "T-së" rrafsh në pjesën e sipërme;
- të lidhë me rrafje, pjesës së shartuar, nga poshtë lart duke lënë të zbuluar sythin;
- të kontrollojë zënien e shartesave pas dy javësh nga realizimi i shartimit;
- të kryejë rishartimin në rastet kur shartesat nuk kanë zënë;
- të kryejnë shërbimet e nevojshme pas shartimit të filazave ne syth fjetur;
- të kujdeset dhe mirëmbajë veglat e shartimit pas përfundimit të punës;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës pas kryerjes së shartimit filizave me syth të fjetur.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët kolegët gjatë shartimit me syth të fjetur.
- të zbatojë rregullat e sigurimin teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë shartimit të filizave me syth të fjetur.

***Instrumentet e vlerësimit:***
– Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi/ja kryen shërbime në shartesore.**

***Kriteret e vlerësimit:***
Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për kryerjen e shërbimeve në shartesore;
- të sigurojë veglat dhe materialet e nevojshme për kryerjen e shëbimeve në shartesore;
- të kontrollojë filizat që kanë zënë dhe kanë syth aktiv;
- të presë me gërshërë nënshartesën 7-8 cm mbi sythin e shartuar;
- të largojë herë pas here lastarët e egër që dalin nga nënshartesa;
- të bëjë prerjen e cepit rrafsh me sythin e butë kur lastari

fuqizohet;
- të kryejë plehërimin e nevojshëm për rritjen e fidanëve;
- të kryejë ujitje sipas nevojave të fidanëve të shartuar;
- të luftojë barërat e këqija sipas agroteknikës përkatëse.
- të mbrojë fidanët e drufrutorëve nga dëmtuesit;
- të shkulë me bel fidanat pa dëmtuar sistemin rrënjor;
- të seleksionojë fidanët sipas standardit të kërkuar;
- të etiketojë fidanët me të dhënat përkatëse: emrin e llojin, kultivarin, nënshartesën dhe kategorinë e fidanit;
- të kryejë shtratifikimin e fidanëve të shartuar;
- të kujdeset për veglat dhe materialet e punës pas kryerjes së shërbimeve në shartesore;
- të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës pas kryerjes së shërbimeve në shartesore;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së shërbimeve në shartesore.
- të zbatojë rregullat e sigurimin teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë gjatë kryerjes së shërbimeve në shartesore.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 5 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e fidanëve të shartur të kulturave drufrutore.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:
- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të përgatisë preventivin e shpenzimeve që duhen gjatë prodhimit të fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore.
- të njëhsojë kostot e prodhimit të fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore, sipas manualit përkatës;
- të njëhsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës;
- të njëhsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës;
- të llogarisë detyrimet fiskale të prodhimit të fidanëve shartuar të kulturave drufrutore, sipas formularëve përkatës;
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një bisnes të vogël për prodhimin e fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore;.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e shkollës ose në fidanishte të kulturave drufrutore.<br>– Mësimdhënësi i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të sigurimit të copave për nënshartesa, prodhimit të filizave për nënshartesa, shartimin e filizave me syth të fjetur, kryerjen e shërbimeve në shartesore, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin e fidanëve të drufrutorëve.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për sigurimin e copave për nënshartesa, prodhimin e filizave për nënshartesa, shartimin e filizave me syth të fjetur, si dhe kryerjen e shërbimeve në shartesore.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta për prodhimin e copave për nënshartesa, prodhimin e filizave për nënshartesa, shartimin e filizave me syth të fjetur, si dhe kryerjen e shërbimeve në shartesore.<br>– Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për prodhimin e fidanëve të shartuar të drufrutorëve.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë prodhimit të fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të prodhimit të copave për nënshartesa, prodhimit të filizave për nënshartesa, shartimin e filizave me syth të fjetur, kryerjes së shërbimeve në shartesore, si dhe të përdorimit të mjeteve të punës për prodhimin e fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore.<br>– Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Thika shartimi, gërshërë, rrafje.<br>– Material ngjitës shartimi shartimi.<br>– Fara bimësh të egra.<br>– Piketa, etiketa, plehra kimike, pesticide, rërë.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e prodhimit të fidanëve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 2. Moduli “Prodhimi i fidanëve të shartuar të hardhisë”

**Kualifikimi:** **Frutikulturë**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PRODHIMI I FIDANËVE TË SHARTUAR TË HARDHISË** | **M-14-455-24** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer procese pune përgatitore të shartimit, shtratifikuar nënshartesat dhe mbishartesat e hardhisë, kryer shartimin e fidanit në tavolinë, kontrolluar procesin e kallusimit, prodhuar fidanë antifilokserik, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike të prodhimit të fidanëve të shartuar të hardhisë në tavolinë. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 69 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK. | |

**Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit**

**RN 1 Nxënësi/ja parapërgatitet për shartimin në tavolinë të fidanit të hardhisë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

– Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
– Të sigurojë të gjithë bazën e nevojshme për shartimin e fidanit të hardhisë në tavolinë, si: tavolinë, gërshërë, lidhëse, rërë, etj.
– Të përzgjedhë veglat dhe njetet e duhura për shartim.
– Të organizojë vendin e punës, sipas parametrave të përcaktuara për shartimin në tavolinë të fidanit të hardhisë.
– Të përcaktojë siç duhet kultivarin e përshtatshëm për shartim.
– Të etiketojë bimët tipike të kultivarit të caktuar për marrjen e kalemave të mbishartesës.
– Të përzgjedhë sharmendat për mbishartesa.
– Të përcaktojë shkallën e pjekurisë së materialit të shartimit sipas kritereve të kërkuara.
– Të përzgjedhë materialin e shartimit sipas kritereve të përcaktuara.
– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përgatitjes së vendit dhe mjeteve për shartimin në tavolinë të fidanit të hardhisë.
– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së vendit dhe mjeteve për shartimin në tavolinë të fidanit të hardhisë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2 Nxënësi/ja shtratifikon nënshartesat dhe mbishartesat e hardhisë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- Të llogarit saktë sasinë e materialeve që i duhen për shtratifikimin e nënshartesave dhe mbishartesave.
- Të përcaktojë saktë kohën e prerjes së nënshartesave.
- Të marrë me kujdes sharmenda me trashësi 6-10 mm për nënshartesa.
- Të seleksionojë nënshartesat sipas parametrave të duhur.
- Të vendosë e të lidhë sharmendat në tufa, 100 copa/tufë.
- Të përgatisë vendin për shtatifikimin e nënshartesave sipas kritereve të kërkuara.
- Të realizojë shtratifikimin e nënshartesave dhe mbishartesave sipas procedurës përkatëse.
- Të pastrojë vendin e punës pas mbarimit të shtratifikimit të nënshartesave.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë shtratifikimit të nënshartesave dhe mbishartesave të hardhisë.
- Të zbatojë siç duhet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtratifikimit të nënshartesave dhe mbishartesave të hardhisë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësi/ja sharton fidanin e hardhisë në tavolinë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- Të veshë patjetër uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të përzgjedhë veglat, mjetet dhe materialet për kryerjen e shartimit të fidanit të hardhisë në tavolinë.
- Të përgatisë vendin, veglat, mjetet dhe materialet për punë
- Të vendos nënshartesat në ujë për 2-3 ditë.
- Të vendosë mbishartesat në ujë për 24 orë.
- Të rifreskojë mbishartesat sipas kritereve të kërkuara.
- Të nxjerrë sythin nga mbishartesa duke kryer prerje 1,5-2 cm mbi syth dhe 5 cm nën syth.
- Të formojë gjuhëzën duke prerë 45 gradë në gjatësinë 40 cm.
- Të formojë gjuhëzën e mbishartesës duke kryer prerje nga ana e sythit.
- Të bashkojë dy komponentët në gjatësinë 40 cm, me tolerancë prej 2 cm.
- Të përgatisë parafinën për parafinimin e shartesave.
- Të bëjë parafinimin e shartesave me parafinë duke i zhytur shartesat 10 cm në enën me parafinë.
- Të përgatisë tallashin duke e lagur me ujë deri sa të bëhet si top kur e shtrëngon.
- Të shtratifikojë shartesat sipas procedurës së kërkuar: pozicion i pjerrët, 5 cm tallazh – 2 shtresa kalemash.
- Të vendosë etiketën me emrin e kultivarit, datën e shartimit dhe emrin e shartuesit.

- Të kujdeset për veglat, mjetet dhe materialet e punës pas kryerjes së shartimit në tavolinë.
- Të pastrojë dhe sistemojë vendin e punës pas kryerjes së shartimit.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së shartimit me syth në tavolinë, të fidanit të hardhisë.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shartimit me syth në tavolinë, të fidanit të hardhisë.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi/ja kontrollon procesin e kallusimit të shartesave.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:
- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të vendosë, sipas rregullit, arkat me shartessa në dhomën e kallusimit.
- Të sigurojë regjimin e duhur teknik të temperaturës në dhomën e kallusimit.
- Të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme procesit të kallusimit deri në mbarim të tij.
- Të përcaktojë momentin e ndërprerjes së kallusimit bazuar në formimin e unazës së kallusimit.
- Të nxjerrë arkat me shartesa, nga dhoma e kallusimit.
- Të kryejë me kujdes seleksionimin e shartesave të kallusuara.
- Të kryejë parafinimit të shartesave 10-15 cm nga pjesa e sipërme.
- Të largojë shartesat e pa kallusuara.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientë kolegët gjatë procesit të kallusimit të shartesave.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të kallusimit të shartesave.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 5 Nxënësi/ja prodhon fidanë të shartuar antifilokserik të hardhisë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:
- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të organizojë siç duhet vendin e punës për prodhimin e fidanëve të shartuar antifilokserik të hardhisë.
- Të përzgjedhë tokën për mbjelljen e fidanëve të shartuar të hardhisë sipas kritereve të përcaktuara.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet për prodhimin e fidanëve të shartuar antifilokserik të hardhisë.
- Të përgatisë tokën për mbjelljen e fidanëve të shartuar të

hardhisë sipas parametrave të kërkuara.
- Të përgatisë vllajat për mbjelljen e fidanëve të shartuar të hardhisë: piketim, nivelim dhe mbulim me plasmas të zi etj.
- Të transportojë me kujdes fidanët e shartuar dhe të parafinuar, në parcelën e caktuar për mbjellje.
- Të përcaktojë siç duhet, parametrat e mbjelljes së fidanëve të shartuar të hardhisë.
- Të kryejë mbjelljen e fidanëve me kunja në 5-7 cm njëri nga tjetri dhe në thellësinë deri në pikën e parafinuar.
- Të vendosë në çdo rrjesht etiketat me të dhënat e kultivarit, nënshartesës etj.
- Të kryejë shërbimet agroteknike pas mbjelljes së fidanëve të shartuar të hardhisë.
- Të shkulë me bel pa dëmtuar sistemin rrënjor, fidanët e shartuar të hardhisë.
- Të seleksionojë fidanët e prodhuar sipas standardit të kërkuar.
- Të vendosë fidanët në tufë dhe t'i lidhë ato.
- Të vendosë etiketat me të dhënat e sakta për secilën tufë.
- Të kujdeset për veglat, pajisjet dhe materialet e punës për prodhimin e fidanëve të shartuar antifilokserik të hardhisë.
- Të pastrojë dhe sistemojë vendin pas kryerjes së proceseve të p për prodhimin e fidanëve të shartuar antifilokserik të hardhisë.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë prodhimit të fidanëve të shartuar antifilokserik të hardhisë.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të fidanëve të shartuar antifilokserik të hardhisë.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 6 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të prodhimit të fidanëve të shartuar të hardhisë në tavolinë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:
- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të përgatisë preventivin e shpenzimeve që duhen gjatë prodhimit të fidanëve të shartuar të hardhisë në tavolinë.
- të njehsojë kostot e prodhimit të fidanëve të shartuar të hardhisë në tavolinë, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë detyrimet fiskale të prodhimit të fidanëve të shartuar të hardhisë në tavolinë.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një bisnes të vogël për prodhimin e fidanëve të shartuar të hardhisë në tavolinë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e shkollës ose në vreshta afër shkollës.
- Mësimdhënësi i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të përgatitjes për punë, shtratifikimit, shartimit, kontrollit të kallusimit, prodhimit të fidanëve të shartuar të hardhisë, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin e fidanëve të shartuar të hardhisë në tavolinë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të përgatitjes për punë, shtratifikimit, shartimit, kontrollit të kallusimit, prodhimit të fidanëve të shartuar të hardhisë, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin e fidanëve të shartuar të hardhisë në tavolinë.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për prodhimin e fidanëve të shartuar të hardhisë në tavolinë.
- Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë prodhimit të fidanëve të shartuar të hardhisë në tavolinë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përgatitjes për punë, shtratifikimit, shartimit, kontrollit të kallusimit, prodhimit të fidanëve të shartuar, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin e fidanëve të shartuar të hardhisë në tavolinë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- material ngjitës shartimi, gërshërë, rrafje, piketa, etiketa, rërë etj.
- Pajisje kancelarie.
- Makina llogaritëse dore.
- Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
- Përmbledhje e legjislacionit në fushën e prodhimit të fidanëve që lidhet me prodhimin e fidanëve frutorë (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
- Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal.

## 3. Moduli “Përpunime të prodhimeve frutore”

**Kualifikimi:** **Frutikulturë**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PËRPUNIME TË PRODHIMEVE FRUTORE** | **M-08-2116-24** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer përpunimin e thjeshtë të frutave për lëng, komposto, reçel, marmalatë, prevedesë, frutave të thata, ullirit për ngrënie dhe përdorimin e konservantëve si dhe për të kryer procese të ndryshme ambalazhimi të tyre me ambalazhe ekologjike, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike për përpunimin e frutave. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 36 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi/ja kryen përpunimin e thjeshtë të frutave për lëngje.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:<br>– të veshë uniformë dhe pajisjet mbrojtëse të punës për përpunimin e frutave për lëng.<br>– të përgatitë vendit dhe mjetet e punës për prodhimin e lëngjeve të frutave, sipas kërkesave të përcaktuara.<br>– të dezinfektojë enët dhe mjedisin e punës, në përputhje me kërkesat.<br>– të përzgjedhë llojin e frutave për prodhimin e lëngut, të tilla si: mollë, dardhë, pjeshkë, qershi etj.<br>– të përcaktojë sasisë e frutave për përpunim, sipas kërkesës së klientit.<br>– të përcaktojë sasisë e sheqerit që do të përdoret në përpunimin e frutave.<br>– të transportojë me kujdes sasinë e frutave dhe të sheqerit në repartin e përpunimit.<br>– të përgatitë enët ambalazhuese të produkteve, sipas kërkesës së klientit.<br>– të përgatitë etiketat për ambalazhim me të gjitha të dhënat e duhura.<br>– të seleksionojë frutat për prodhimin e lëngut, sipas kritereve të frutave për prodhim lëngu.<br>– të lajë frutat me ujë të rrjedhshëm.<br>– të heqë farat, bërthamat dhe cipat nga frutat. |

- të copëtojë frutat në mënyrë manuale.
- të shtrydhë frutat me pajisje manuale ose elektrike.
- të përgatitë ambalazhin e duhur për mbushjen me lëng frutash, sipas sasisë së lëngut dhe kërkesës së klientit.
- të filtrojë lëngun e prodhuar, duke ruajtur tejdukshmërinë.
- të hedhë lëngun nëpër enët përkatëse, sipas kërkesës.
- të përdorë konservantët e lejuar për ruajtjen e lëngjeve të përpunuara.
- të ambalazhojë produktin me ambalazhe ekologjike, sipas kërkesës dhe standardeve.
- të etiketojë produktin e ambalazhuar sipas rregullit.
- të lajë dhe pastrojë enët dhe mjetet të tjera të përdorura gjatë përpunimit të frutave për lëng.
- të pastrojë vendin e përpunimit të frutave, sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- të grumbullojë dhe transportojë mbeturinat e ndryshme me mjetet e duhura dhe në vendin e caktuar.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë prodhimit të lëngut të frutave.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë prodhimit të lëngut të frutave.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2 Nxënësi/ja kryen përpunime të thjeshta të frutave për komposto.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë kompletit e punës për përpunimin e frutave për komposto.
- të përzgjedhë mjetet e punës për prodhimin e kompostos.
- të dezinfektojë enët dhe mjedisin e punës për prodhimin e kompostos së frutave.
- të përzgjedhë frutat për përpunim, në pjekjen jo të plotë të tyre.
- të përcaktojë sasinë e frutave dhe të sheqerit për përpunim sipas kërkesës.
- të transportojë frutat dhe sheqerin në repartin e përpunimit.
- të lajë frutat me ujë të rrjedhshëm dhe t'i pastrojë nga papastërtitë.
- të peshojë frutat dhe sheqerin sipas llojit të frutit të përzgjedhur.
- të përcaktojë masën e ujit sipas llojit të frutit që do të përpunohet.
- të përmasojë frutat, sipas standardit të kërkuar.
- të heqë farat, bërthamat dhe cipat e frutave.
- të presë frutat në copa të mëdha.

- të blansherojë frutat.
- të përgatisë shurupin e sheqerit për prodhimin e kompostos sipas standardit.
- të ziejë frutat për komposto.
- të kontrollojë vazhdimisht zierjen e frutave deri në ndalimin e saj.
- të përdorë konservantët e lejuar për ruajtjen e komposotove të përpunuara.
- të mbushë enët me komposto, sipas kërkesës dhe standardit.
- të ambalazhojë produktin sipas kërkesës me ambalazhe ekologjike.
- të etiketojë produktin, me të dhënat përkatëse.
- të maganizojë produktin e prodhuar.
- të pastrojë vendin e punës pas prodhimit të kompostos sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- të grumbullojë dhe transportojë mbeturinat e ndryshme me ı duhura dhe në vendin e caktuar.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë prodhimit të kompostos së frutave.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kompostos së frutave.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësi/ja kryen përpunime të thjeshta të frutave për reçel.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës për përpunimin e frutave për reçel.
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet për përpunimin e frutave për reçel.
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e reçelit dhe kompostos sipas procedurave standarde.
- të dezinfektojë enët e mjedisin e punës sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- të transportojë frutat dhe sheqerin në repart.
- të përgatisë enët për ambalazhimin e produktit.
- të përgatisë etiketat me të dhënat përkatëse të produktit.
- të seleksionojë frutat për prodhimin e reçelit sipas parametrave teknologjikë të këtij procesi.
- të lajë me ujë të rrjedhshëm dhe të pastrojë frutat nga bishtat dhe gjethet frutat.
- të peshojë frutat dhe sheqerin që duhet për prodhimin e reçelit.
- të heqë farat, bërthamat dhe cipat.

- të blansherojë frutat.
- të përgatisë shurupin e sheqerit për prodhimin e reçelit sipas kërkesave teknologjike të këtij procesi.
- të ziejë masën e përgatitur sipas proceseve tekike për prodhimin e reçelit.
- të kontrollojë në vazhdimësi dhe të përziejë masën deri sa të kryhet lidhja e fortë midis përbërësve.
- të vendosë masën për ftohje natyrale.
- të mbushë enët me reçel sipas kërkesës dhe satandardit.
- të përdorë konservantët e lejuar për ruajtjen e reçelit të përpunuar.
- të ambalazhojë enët e mbushura me reçel sipas standardit dhe me ambalazhe ekologjike.
- të etiketojë enët e ambalazhuara me të gjithe të dhënast përkatëse.
- të magazinojë produktin e prodhuar.
- të grumbullojë dhe të transportojë mbeturinat e ndryshme me mjetet e duhura dhe në vendin e caktuar.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë punës së përpunimit të frutave për reçel.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës së përpunimit të frutave për reçel.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi/ja kryen përpunime të thjeshta të frutave për marmalatë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës për përpunimin e frutave për marmalatë.
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet për përpunimin e frutave për marmalatë.
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e marmalatës sipas procedurave standarde.
- të dezinfektojë enët dhe mjedisin e punës sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- të transportojë frutat dhe sheqerin në repart.
- të seleksionojë me kujdes frutat për prodhimin e marmelatës.
- të lajë mirë frutat.
- të copëtojë frutat sipas madhësisë së duhur.
- të zjejë frutat e copëtuara për përftimin e puresë së frutave.
- të përgatisë sheqerin, pektinën dhe acidit organik për prodhimin e marmelatës.
- të kontrollojë procesin e pasirimit të puresë së frutave.
- të ftohë marmelatën.

- të përdorë konservantët e lejuar për ruajtjen e marmalatës të përpunuar.
- të përgatisë ambalazhet e produktit sipas kërkesës dhe standardit me ambalazhe ekologjike.
- të mbushë enët e ambalazhit me marmalatë sipas këkesës dhe standardit.
- të etiketojë enët e ambalazhuara.
- të magazinojë produktin e prodhuar e të ambalazhuar.
- të grumbullojë dhe transportojë mbeturinat e ndryshme në vendin e caktuar.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përpunimit të frutave për marmalatë.
- të zbatojë rregullat e sigurimin teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përpunimit të frutave për marmalatë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 5 Nxënësi/ja kryen përpunime të thjeshta të frutave për prevede.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës për përpunimin e frutave për prevede.
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet për përpunimin e frutave për prevede.
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e prevedesë sipas procedurave standarde.
- të dezinfektojë enët dhe mjedisin e punës sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- të transportojë frutat dhe sheqerin në repart
- të seleksionojë me kujdes frutat për prodhimin e prevedesë
- të lajë frutat
- të lajë me ujë të rrjedhshëm dhe të pastrojë frutat nga papastërtitë.
- të copëtojë frutat sipas kërkesave teknologjike të procesit
- të zjejë frutat e copëtuara për përftimin e puresë së frutave
- të kullojë masën e zjerë me ½ e masës së sheqerit të frutave për
- përftimin e lëngut të frutave.
- të përziejë ½ tjetër të masës së sheqerit në lëngun e përftuar.
- të vazhdojë zierjen dhe deri në përftimin e masës xhelatin
- të përgatisë prevedenë sipas standardit të caktuar.
- të vendosë masën e përftuar, për ftohje, në forma dhe enë të caktuara.
- të përdorë konservantët e lejuar për ruajtjen e prevedesë të përpunuar.
- të përgatisë enët e ambalazhit të produktit, sipas kërkesës dhe standardit ekologjik.
- të etiketojë ambalazhet e produktit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 6 Nxënësi/ja kryen përpunime të thjeshta të frutave të thata.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës për përpunimin e frutave për tharje.
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet për përpunimin e frutave për tharje.
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e frutave
- te thata sipas ss sipas procedurave standarde.
- të dezinfektojë enët dhe mjedisin e punës sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- të transportojë frutat në repartin e tharjes.
- të seleksionojë me kujdes frutat për prodhimin e frutave të thata.
- të lajë mirë frutat.
- të vendosë frutat për tharje në vendet e tharjes sipas kategorive,
- të thajë frutat sipas kërkesave teknike sipas llojit të frutit.
- të përdorë konservantët e lejuar për ruajtjen e marmelatës të përpunuar.
- të përgatisë ambalazhet e produktit sipas kërkesës dhe standardit me ambalazhe ekologjike.
- të etiketojë produktet e ambalazhuara.
- të magazinojë produktin e prodhuar e të ambalazhuar.
- të gumbullojë dhe transportojë mbeturinat e ndryshme në vendin e caktuar.
- të zbatojë rregullat e sigurimin teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përpunimit të frutave të thata.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 7 Nxënësi/ja kryen përpunime të thjeshta të ullirit për ngënie.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës për përpunimin e ullirit për ngrënie.
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet për përpunimin e ullrit për ngrënie (tavolinë ose kriposje).
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimit të ullirit për tavolinë sipas procedurave standarde.
- të dezinfektojë enët dhe mjedisin e punës sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- të transportojë ullirin në repartin e përpunimit.
- të seleksionojë me kujdes ullinjtë për përpunim.
- të lajë me ujë të rrjedhshëm ullinjtë dhe të pastrojë frutat nga bishtat dhe gjethet.
- të presë ullinjtë sipas kërkesave teknologjike të procesit
- të bëjë kriposjen e ullinjve sipas kërkesave.
- të përdorë konservantë të tjerë të lejuar për ruajtjen e ullinjve të përpunuar.

- të përgatisë enët e ambalazhit të produktit, sipas kërkesës dhe standardit dhe të përdorë ambalazhe ekologjike.
- të etiketojë ambalazhet e produktit.
- të magazinojë produktin e prodhuar e të ambalazhuar.
- të grumbullojë dhe transportojë mbeturinat e ndryshme, në vendin e caktuar për to.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë përpunimit ullirit për ngrënie.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përpunimit ullirit për ngrënie.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 8 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të përpunimit të thjeshtë të prodhimeve frutore.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të përgatisë preventivin e shpenzimeve që duhen gjatë përpunimit të thjeshtë të prodhimeve frutore.
- të njehsojë kostot e përpunimit të thjeshtë të prodhimeve frutore, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë detyrimet fiskale të përpunimit të thjeshtë të prodhimeve frutore.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një bisnes të vogël për përpunimin e thjeshtë të prodhimeve frutore.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të përpunimit të frutave dhe perimeve<br>– Mësimdhënësi i praktikës, ose teknologu i repartit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për përpunimin e thjeshtë të prodhimeve frutore për lëng, komposto, reçel, marmelatë e prevede, fruta të thata dhe ullirit për ngrënie si dhe ambalazhimin e tyre.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmelatës e prevedesë, frutave të thata dhe ullirit për ngrënie si dhe ambalazhimin e tyre.<br>– Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmelatës e prevedesë, frutave të thata dhe ullirit për ngrënie si dhe ambalazhimin e tyre.<br>– Instruktori i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë |

| | |
|---|---|
| | përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për përpunimin e frutave.<br>– Mësimdhënësi i praktikës ose teknologu i repartit duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmalatës, prevedesë së frutave, frutave të thata dhe ullirit për ngrënie si dhe ambalazhimin e tyre.<br>– Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:<br>– repart për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmalatës e prevedesë, frutave të thata dhe ullirit për ngrënie.<br>– mjete pune për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmalatës e prevedesë, frutave të thata dhe ullirit për ngrënie si dhe ambalazhimin e tyre.<br>– lëndë të para dhe ndihmëse për prodhimin e lëngut, kompostos, reçelit, marmalatës, prevedesë, frutave të thata dhe ullirit për ngrënie.<br>– pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde industriale, etj.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e përpunimit që lidhet me përpunimin e frutave (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 4. Moduli "Shërbimet agroteknike dhe vjeljen në pemëtore dhe vreshta"

**Kualifikimi:** **Frutikulturë**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **SHËRBIMET AGROTEKNIKE DHE VJELJA NË PEMËTORE DHE VRESHTA** | **M-14-2117-24** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për kryerjen e plehërimit të tokës, punimit të tokës, ujitjes së pemëve frutore dhe vreshtave, krasitjes së gjelbër, trajtimeve fitosanitare të mbrojtjes së kulturave drufrutore dhe vreshtave, vjeljes së kulturave drufrutore, si dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike të shërbimeve në kulturat drufrutore në prodhim. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 66 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional "Bujqësi", Niveli II në KSHK. | |

| | | |
|---|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit (RN), dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi/ja plehëron tokën në pemëtore dhe vreshta.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:<br>– Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për plehërimin e tokës në pemëtore dhe vreshta.<br>– Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe makineritë e duhura për plehërimin e tokës në pemëtore dhe vreshta.<br>– Të marrë mostra për analiza kimike të tokës.<br>– Të përcaktojë llojin dhe sasinë e plehrave organike, sipas llojit të tokës dhe të kulturës së mbjellë.<br>– Të përcaktojë sasinë e plehrave kimike, sipas nevojave të kulturës së mbjellë.<br>– Të përcaktojë llojet e plehrave që përdoren në plehërimin plotësues dhe atë gjethor me plehra organike dhe minerale;<br>– Të përcaktojë mënyrat, teknikat, sasitë dhe kohën e plehërimit plotësues dhe gjethor;<br>– Të përcaktojë mjetet e nevojshme për transportimin e plehut në pemëtore dhe vreshta.<br>– Të përcaktojë pajisjet digjitale për monitorimin e sasisë së lëndëve ushqyesve për plehërimin e kulturave drufrutore dhe hardhive;<br>– Të transportojë sasinë e plehrave të përcaktuara në pemëtore dhe vreshta në prodhim.<br>– Të përcaktojë mënyrën e plehërimit të tokës në pemëtore dhe vreshta, me krah ose makineri, sipas mundësive të mekanizimit.<br>– Të kryejë plehërimin e tokës në pemëtore dhe vreshta, sipas |

mënyrës së zgjedhur.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe makineritë pas plehërimit të tokës në pemëtore dhe vreshta, në përputhje me rregullat teknike të tyre.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së plehërimit të tokës në pemëtore dhe vreshta.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe e të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së plehërimit të tokës në pemëtore dhe vreshta.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2 Nxënësi/ja punon tokën në pemëtore dhe vreshta.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:
- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për punimin e tokës në pemëtore dhe vreshta.
- Të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për punimin e tokës në pemëtore dhe vreshta.
- Të transportojë veglat e pajisjet për punimin e tokës në pemëtore dhe vreshta.
- Të kontrollojë dhe përgatisë veglat dhe pajisjet e punimit të tokës për punë.
- Të përcaktojë mënyrën e mbajtjes së tokës në pemëtoret dhe vreshtat në prodhim (livadh ose të punuar rreth kurorës së pemës).
- Të kryejë punimin e tokës me krah rreth kurorës së pemëve dhe hardhive.
- Të kryejë punimin e tokës midis rreshtave të pemëve dhe hardhive, me krah ose me mjete mekanike, sipas mundësive të mekanizimit të pemëtores ose vreshtit.
- Të grumbullojë mbeturinat e nxjerra nga punimi i tokësi gurë apo barëra të këqija dhe largimi i tyre nga pemëtorja dhe vreshti.
- Të kujdeset dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe makineritë e punimit të tokës në pemëtore dhe vreshta në prodhim.
- Të pastrojë dhe sistemojë vendin pas punimit të tokës në pemëtore dhe vreshta.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë punimit të tokës në pemëtore dhe vreshta.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimit të tokës në pemëtore dhe vreshta.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësi/ja kryen ujitje në pemëtore dhe vreshta.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:
- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për ujitje në pemëtore dhe vreshta.
- Të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e nevojshme për ujitjen e pemëve në pemëtore dhe vreshta.
- Të transportojë me kujdes veglat e pajisjet e ujitjes në pemëtore dhe vreshta.
- Të përcaktojë mënyrën e mënyrës e ujitjes në pemëtore dhe vreshta.
- Të kryejë ujitjen me brazda në pemëtore dhe vreshta sipas teknikës së duhur dhe nevojave të kulturës.
- Të kryejë ujitjen me tava në pemëtore dhe vreshta sipas teknikës së duhur dhe nevojave të kulturës.
- Të kryejë ujitjen me impiant në pemëtore dhe vreshta sipas teknikës së duhur dhe nevojave të kulturës.
- Të kryejë ujitjen me pika në pemëtore dhe vreshta sipas teknikës së duhur dhe nevojave të kulturës.
- Të pastrojë vendin e punës pas ujitjes së pemëve dhe hardhive, sipas rregullit të caktuar.
- Të kujdeset dhe mirëmbajë veglat dhe pajisjet e ujitjes në pemëtore dhe vreshta.
- Të pastrojë pemëtoren dhe vreshtin pas ujitjeve të kryera.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë ujitjes së pemtoreve dhe vreshtave.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë ujitjes së pemëtoreve dhe vreshtave.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi/ja kryen krasitjen dimërore dhe të gjelbër në pemëtore dhe vreshta.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:
- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për krasitjen dimëroe dhe të gjelbër në pemëtore dhe vreshta.
- Të përzgjedhë veglat dhe materialet e duhura për krasitjen dimërore dhe të gjelbër të pemëve në pemëtore dhe vreshta.
- Të kontrollojë dhe përgatisë veglat dhe materialet e krasitjes për punë.
- Të përcaktojë formën e mbajtjes së kurorës së pemëve dhe hardhive sipas kërkesave të kulturave.
- Të kryejë krasitjen e gjelbër te pemët frutore sipas teknikës së duhur.
- Të kryejë krasitjen e gjelbër të hardhive sipas teknikës së duhur.
- Të pastrojë sipërfaqen e pemëtores dhe vreshtave nga mbetjet e krasitjes të pemëve drufrutore dhe hardhive.
- Të kujdeset dhe mirëmbajë veglat dhe materialet e krasitjes

të pemëve në pemëtore dhe vreshta.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë krasitjes të pemëve në pemëtore dhe hardhive.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë krasitjes të pemëve në pemëtore dhe hardhive.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 5 Nxënësi/ja trajton kulturat në pemëtore dhe vreshta për mbrojtjen nga dëmtuesit.**

***Kriteret e vlerësimit:***
Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:
- Të veshë uniformës dhe pajisjet mbrojtëse të punës gjatë trajtimit të kulturave në pemëtore dhe vreshta.
- Të përzgjedhë vegla dhe materialet për trajtimin e kulturave në pemëtore dhe vreshta.
- Të kontrollojë dhe përgatitë veglat dhe materialet për punë për trajtimin e pemëve dhe hardhive.
- Të përcaktojë llojin e kulturës drufrutore për trajtim (farore, bërthamore, ulliri, hardhia, agrume, hardhi etj.).
- Të diagnostikojë saktë pemët/hardhitë e prekura nga dëmtues në pemëtore dhe vreshta.
- Të përcaktojë metodat e kontrollit digjital të dëmtuesve të pemëve frutore dhe hardhive;
- Të përcaktojë dëmtuesit në pemëtore dhe vreshta.
- Të përcaktojë numrin e saktë për rrënjë të pemëve/ hardhive për trajtime kimike.
- Të përgatisë mjetin dhe pompën për spërkatje sipas procedurës teknike.
- Të përcaktojë preparatin e duhur kimik sipas llojit të dëmtuesit.
- Të përcaktojë siç duhet sasinë e ujit dhe të preparatit kimik duke respektuar raportin e përzierjes së tyre.
- Të përgatisë preparatin e lëngshëm kimik sipas raportit të përcaktuar për përzierje.
- Të mbushë pompën ose botin e mjetit me lëngun kimik sipas rregullit teknik.
- Të kryejë spërkatjen në çdo kurorë peme/hardhie të prekur nga sëmundje apo dëmtues sipas procedurës së punës.
- Të pastrojë dhe mirëmbajë mjetin dhe botin spërkatës pas kryerjes së spërkatjes së pemëve në pemëtore.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë trajtimeve me preparate kimike të lëngshme të pemëve në pemëtore dhe vreshta.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimeve me preparate kimike të lëngshme

të pemëve në pemëtore dhe vreshta.

***Instrumentet e vlerësimit:***

– Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 6 Nxënësi/ja kryen vjeljen e kulturave drufrutore.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

– Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për vjeljen së kulturave në pemëtore dhe vreshta.
– Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet për vjeljen në pemëtore dhe vreshta.
– Të kontrollojë dhe përgatisë veglat dhe materialet e vjeljes në pemëtore dhe vreshta për punë, sipas llojit të kulturës.
– Të përzgjedhë llojin e kulturës drufrutore për vjelje.
– Të përcaktojë momentin e vjeljes sipas kohës së pjekjes së frutave dhe drejtimit të prodhimit.
– Të përdorë platformat digjitale për monitorimin e kohës së vjeljes së prodhimeve frutore dhe rrushit;
– Të përcaktojë mënyrën e vjeljes sipas llojit të kulturës së përzgjedhur.
– Të kryejë vjeljen e kulturës drufrutore/hardhisë, me krah ose në mënyrë mekanike.
– Të vendosë me shumë kujdes frutat e vjelë në ambalazhe të posaçme sipas llojit të frutit.
– Të transportojë, me krah apo mjete mekanike, frutat e vjelë në magazinë.
– Të seleksionojë frutat e dëmtuar dhe standardizojë frutat e shëndoshë sipas drejtimit të përdorimit.
– Të ambalazhojë prodhimin sipas kërkesës me ambalazhe ekologjike.
– Të ruajë prodhimin në magazinë sipas kërkesave të përcaktuara të ruajtjes për çdo kulturë drufrutore/hardhi.
– Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet, mjetet dhe materialet pas vjeljes në pemëtore dhe vreshta.
– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë vjeljes së kulturave drufrutore dhe rrushit.
– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vjeljes në pemëtore dhe vreshta.

***Instrumentet e vlerësimit:***

– Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 7 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të shërbimeve agroteknike dhe vjeljes në pemëtore dhe vreshta.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

– të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.

| | |
|---|---|
| | – të përgatisë preventivin e shpenzimeve që duhen gjatë shërbimeve groteknike dhe të vlejles në pemëtore dhe vreshta.<br>– të njehsojë kostot e shërbimeve agroteknike dhe të vjeljes në pemëtore dhe vreshta, sipas manualit përkatës.<br>– të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.<br>– të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.<br>– të llogarisë detyrimet fiskale të shërbimeve agroteknike dhe te vjeljes në pemëtore dhe vreshta, sipas formularëve përkatës.<br>– të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për shërbimet agrotrknike dhe të vjeljes në pemëtore dhe vreshta.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul mund të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në pemëtore, ullishte, vreshta dhe agrumishte sipas mundësive që ofron zona dhe rajoni ku ndodhet shkolla.<br>– Gjatë trajtimit të modulit mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë demostrime konkrete të kryerjes së shërbimeve agroteknike dhe të vjeljes në pemëtore dhe vreshta të tilla si: punimi i tokës, plehërimi, ujitja, krasitja, luftimi i dëmtuesve, vjelja, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me këto shërbime.<br>– Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë mundur të kryerjes së shërbimeve agroteknike dhe të vjeljes në pemëtore dhe vreshta të tilla si: punimi i tokës, plehërimi, ujitja, krasitja, luftimi i dëmtuesve, vjelja, si dhe si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me këto shërbime.<br>– Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve gjatë kryerjes së shërbimeve agroteknike në pemëtore dhe vreshta.<br>– Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së së shërbimeve agroteknike dhe të vjeljes në pemëtore dhe vreshta.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të kryerjes së shërbimeve agroteknike dhe të vjeljes në pemëtore dhe vreshta të tilla si: punimi i tokës, plehërimi, ujitja, krasitja, luftimi i sëmundjeve e dëntuesve, vjelja, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me këto shërbime.<br>– Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. |

| | |
|---|---|
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:<br>– Baza prodhuese e shkollës (pemëtore, vreshtari, ullishte apo agrumishte)<br>– Mjete të tjeshta pune krahu dhe të mekanizuara për kryerjen e shërbimeve.<br>– Mjete transporti.<br>– Pankarta, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde industriale etj.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e shërbimeve që lidhet me shërbimet në pemëtore, vreshtari, ullishte dhe agrumishte (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 5. Moduli “Shartimi i kulturave drufrutore dhe hardhive”

**Kualifikimi:** **Frutikulturë**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **SHARTIMI I KULTURAVE DRUFRUTORE DHE HARDHISË** | **M-14-458-24** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer shartim me kalem me çarje të plotë, shartimin me kalem nën lëvore në kulturat drufrutore, shartimin me koopulim të pemëve frutore dhe hardhisë, shtimin me hink në vend të agrumeve, si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me shartimin në vend të kulturave drufrutore dhe hardhive. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 36 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, Niveli II në KSHK. | |

| | | |
|---|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi/ja sharton në vend, me kalem me çarje të plotë në kulturat farore.**<br>***Kriteret e vleresimit:***<br>Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:<br>– Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.<br>– Të përzgjedhë materialet, veglat e pajisjet përkatëse për shartim me kalem me çarje të plotë në kulturat farore.<br>– Të transpotojë veglat, pajisjet e materialet në pemëtore.<br>– Të përgatisë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për shartim.<br>– Të përcaktojë llojin e kulturës dhe pemët që do të shartohen me kalem me çarje të plotë, sipas kritereve të përcaktuara.<br>– Të përcaktojë llojin e kulturës dhe pemët ku do të merren copat për mbishartesë, sipas kritereve të përcaktuara.<br>– Të llogarisë sasinë e materialeve të duhura për shartim.<br>– Të realizojë prerjen e copave të mbishartesës, sipas hapave të punës.<br>– Të shtratifikojë në rërë dhe të ruajë copat në kushte optimale.<br>– Të zbatojë teknikën e prerjeve për përgatitjen e nënshartesës.<br>– Të zbatojë teknikën e prerjeve për përgatitjen e kalemave si mbishartesë.<br>– Të realizojë vendosjen dhe puthitjen e mbishartesës me nënshartesën, sipas procedurës.<br>– Të kryejë lidhjen e vendit të shartimit me rafije, sipas |

rregullit të duhur.
- Të kryejë izolimin e vendit të shartimit me material ngjitës.
- Të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme zënien e shartimit.
- Të pastrojë vendin e punës pas kryerjes së shartimit sipas rregullit.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë shartimit me kalem me çarje të plotë në kulturat farore.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë shartimit me kalem me çarje të plotë në kulturat farore.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2 Nxënësi/ja sharton në vend, me kalem nën lëvore kulturat drufrutore.**

***Kriteret e vlerësimit***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punëspër shart kalem nën lëvore te kulturat drufrutore.
- Të përzgjedhë materialet, veglat, paisjet përkatëse për shartim me kalem nën lëvore te kulturat drufrutore.
- Të përllogarisë me saktësi sasinë e materialeve të nevojshme për shartim me kalem nën lëvore te kulturat drufrutore.
- Të transportojë veglat, pajisjet, matrialet në vendin ku do të kryhet shartimi me kalem nën lëvore.
- Të përgatisë për punë veglat, pajisjet, matrialet në vendin ku do të kryhet shartimi me kalem nën lëvore.
- Të përcaktojë pemët që do të shartohen.
- Të presë rrafsh ose me pak pjerrësi nënshartesën.
- Të çajë vertikalisht lëvoren e nënshartesës me gjatësi 3-4 cm.
- Të përgatisë me kujdes në formë gjuhëze me dy sytha (kalemi) mbishartesën.
- Të vendosë me kujdes mbishartesën te nënshartesa.
- Të puthisë, siç duhet, gjuhëzën e mbishartesës me drurin e zbuluar të nënshartesës.
- Të lidhë me kujdes, kalemin e shartuar nga poshtë -lartë.
- Të izolojë vendin e shartimit me material ngjitës sipas procedurës.
- Të afrojë me kujdes dheun afër pikës së shartimit.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë shartimit me kalem nën lëvore te kulturat drufrutore.
- Të zbatojë me rigorizitet rregullat sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit gjatë shartimit me kalem nën lëvore te kulturat drufrutore.

*Instrumentet e vlerësimit:*

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësi/ja sharton, në vend, me koopulim në pemët frutore dhe hardhi.**

*Kriteret e vlerësimit*

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për shartimin me koopulim në pemët frutore dhe hardhi.
- Të përzgjedhë materialet, veglat, pajisjet përkatëse për shartimin me koopulim në pemët frutore dhe hardhi.
- Të përllogarisë materialet e nevojshme për shartim me koopulim .
- Të transportojë veglat, pajisjet dhe materialet në vëndin e punës ku do të realizohet shartimi me koopulin.
- Të përgatisë veglat, pajisjet dhe materialet për realizimin e shartimit me koopulim në pemët frutore dhe hardhi.
- Të përcaktojë pemët dhe hardhitë për shartim me koopulim.
- Të përcaktojë pemët nga ku do të merren mbishartesat për shartim me koopulim.
- Të përgatisë qafën e rrënjës së nënshartesës për shartim.
- Të përgatisë kalemin në fomë pile me gjatësi dhe kënde të caktuar.
- Të vendosë mbishartesën te nënshartesa me trashësi të barabartë.
- Të puthisë mirë mbishartesën te nënshartesa në sqetullën e njëra –tjetrës.
- Të lidhë mirë pikën e shartimit me plasmas.
- Të lyejë pikën e shartimit me material ngjitës.
- Të kontrollojë zëniet e pemëve/hardhive të shartuara.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë shartimit me koopulim te pemët frutore dhe hardhitë.
- Të zbatojë me rigorizitet rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit gjatë shartimit me koopulim te pemët frutore dhe hardhitë.

*Instrumentet e vlerësimit:*

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi/ja shton, në vend agrumet, me hink.**

*Kriteret e vlerësimit*

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës për shtimin në vend të agrumeve, me hink,.
- Të përzgjedhë materialet, veglat dhe pajisjet përkatëse për shtimin në vend të agrumeve nme hink.
- Të përllogarisë materialet e nevojshme për shtimin në vend të agrumeve: plasmas, dherishte, brisqe, thikë, etj.

- Të transpotojë me kujdes veglat, pajisjet e materialet në vëndin e punës dhe t'i përgatisë ato për punë.
- Të përcaktojë agumet për shtim sipas kushte konkrete.
- Të përzgjedhë degëzën e veshur me gjethe, sipas kritereve të caktuara.
- Të unazojë degëzën sipas përmasave të caktuara.
- Të mbështjellë me kujdes pjesën e zhveshur me hinkë plasmani dhe ta shtrëngojë mirë atë.
- Të mbushë hinkën me lëndë ushqyeseqë favorizon rrënjëzimin.
- Të ujisë në mënyrë të vazhdueshme dhe me lëndë ushqyese.
- Të shkëpusë degën e unazuar së bashku me hinkën pa e dëmtuar atë.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë shtimit në vend të agrumeve.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtimit në vend të agrumeve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 5 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të shartimit në vend të kulturave drufrutore dhe hardhive.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të përgatisë preventivin e shpenzimeve që duhen gjatë shartimit në vend të kulturave drufrutore dhe hardhisë.
- të njehsojë kostot e shartimit në vend të kulturave drufrutore dhe hardhisë, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë detyrimet fiskale të shartimit në vend të kulturave drufrutore dhe hardhisë, sipas formularëve përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për shartimin në vend të kulturave drufrutore dhe hardhisë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e shkollës ose në pemëtore a vresht pranë saj.
- Mësimdhënësi i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të përgatitjes për punë, të shartimit me kalem me çarje të plotë, të shartimit me kalem nën lëvore, shtimin në vend të agrumeve, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me shartimin në vend të kulturave

| | |
|---|---|
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për prodhimin e fidanëve të shartuar të agrumeve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e shkollës ose në fidanishte përkatëse.<br>– Mësimdhënësi i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të prodhimit të filizave të egër për nënshartesa, prodhimit të nënshartesave të agrumeve në kubikë, shartimit të filizave me syth të fjetur, kryerjen e shërbimeve në shartesore, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike ludhur me prodhimin e fidanëve të shartuar të agrumeve.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për prodhimin e filizave të egër për nënshartesa, prodhimin e filizave për nënshartesë në kubikë, shartimin e filizave me syth të fjetur, si dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme në shartesore për prodhimin e fidanëve të shartuar të agrumeve.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta për prodhimin e fidanëve të shartuar të agrumeve.<br>– Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për prodhimin e fidanëve të shartuar të agrumeve.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë prodhimit të fidanëve të shartuar të agrumeve.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të prodhimit të filizave për nënshartesa, shartimit të filizave të agrumeve me syth të fjetur, kryerjen e shërbimeve në shartesore, si dhe llogaritjet e |

| | |
|---|---|
| | thjeshta ekonomike për prodhimin e fidanëve të shartuar të agrumeve.<br>– Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Thika shartimi<br>– Gërshërë<br>– Rrafje<br>– Material ngjitës shartimi<br>– Fara bimësh të egra<br>– Piketa, etiketa<br>– Plehra kimike<br>– Pesticide<br>– Rërë, qese të zeza plastike<br>– Torfë<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e prodhimit të fidanëve që lidhet me prodhimin e fidanëve të agrumeve (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 4. Moduli "Kontrolli biologjik i dëmtuesve në pemtore e vreshta"

**Kualifikimi:** **Frutikulturë**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

*PËRSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **KONTROLLI BIOLOGJIK I DËMTUESVE NË PEMTORE E VRESHTA** | **M-14-2120-24** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të organizuar punën, kryer kontrolle fushore, monitorime dhe zbatuar kontrollin biologjik të dëmtuesve të pemëve frutore dhe hardhive, pa trajtime kimike, me qëllim mbrojtjen biologjike dhe marrjen e prodhimeve frutore cilësore. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin profesional "Bujqësi", Niveli II në KSHK. | |
| **Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit** | **RN 1** | **Nxënësi/ja kryen kontrollin dhe monitorimin fushor të dëmtuesve në pemtore dhe vreshta.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:<br>– të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë kryerjes së kontrollit fushor të dëmtuesve të kulturave frutore.<br>– të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e kontrollit fushor.<br>– të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për kryerjen e kontrollit fushor.<br>– të përcaktojë saktë qëllimin e kontrollit fushor për llojin e dëmtuesit që prek llojet e pemëve frutore dhe hardhive.<br>– të përzgjedhë llojin e kulturës drufrutore dhe parcelat që do të organizojë kontrollin.<br>– të hartojë planin e vrojtimit për një parcelë të dhënë, duke përfshirë datat dhe kohën e saktë të kryerjes së vrojtimeve.<br>– të përcaktojë fazën fenologjike të kulturës sipas karakteristikave të rritjes normale të saj.<br>– të identifikojë bimët e prekura në parcelë sipas karakteristikave të rritjes jo normale të tyre dhe shenjave dalluese.<br>– të vendosë letra ngjitëse me ngjyra përkatëse për kontrollin e popullatave të dëmtuesve të ndryshëm në pemtore e vreshta.<br>– të diagnostikojë saktë llojin e dëmtuesit.<br>– të përcaktojë kohën dhe shkallën e prekjes së kulturës drufrutore nga dëmtuesit. |

– të bëjë vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes së kulturës.
– të realizojë me korrektësi planin e kontrollit fushor duke respektuar datat dhe kohën e vrojtimit.
– të mbajë saktë shënimet për parcelën e monitoruar lidhur me kulturën përkatëse dhe dëmtuesit.
– të plotësojë saktë dokumentacionin përkatës të kontrollit fushor për dëmtuesit e kulturës drufrutore.
– të analizojë të dhënat për të përcaktuar dëmin ekonomik të shkaktuar nga infektime të ndryshme.
– të krahasojë gjendjen aktuale të kulturës së përzgjedhur me standardin e lejuar ekonomik për të ndërhyrë për mbrojtjen e tyre.
– të raportojë të dhënat e kontrollit fushor në instanca më të larta përgjegjëse për marrjen e masave të kontrollit biologjik të dëmtuesve.
– të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë kryerjes së kontrollit fushor të dëmtuesve të kulturave drufrutore.
– të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit fushor të dëmtuesve të kulturave drufrutore.

***Instrumentet e vlerësimit:***

– Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 2 Nxënësi/ja zbaton masat për kontrollin biologjik të kulturave drufrutore nga dëmtuesit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë zbatimit të masave të kontrollit biologjik të mbrojtjes së kulturave drufrutore nga dëmtuesit.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për zbatimin e masave të kontrollit biologjik të kulturave drufrutore nga dëmtuesit.
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për zbatimin e masave të kontrollit biologjik të kulturave drufrutore nga dëmtuesit.
- të zbatojë masat agroteknike të mbrojtjes së kulturave drufrutore ndaj dëmtuesve, të tilla si: pastrimi dhe higjienizimi i vendit apo zonës së infektuar, punimi i tokës, mbjellja e varieteve rezistente nga dëmtuesve, qarkullimi bujqësor, bashkëshoqërimi i kulturave bujqësore etj.
- të zbatojë masat fiziko-mekanike të mbrojtjes së kulturave drufruore ndaj dëmtuesve, të tilla si: përdorimi i metodës së ftohtë apo të nxehtë, për eleminimin e dëmtuesve apo ngadalësimin e rritjes, përdorimi i rrjetave të posaçme, kurtheve, kurtheve me melasë, letrave ngjitëse dhe qaforeve për kapjen e dëmtuesve etj.
- të zbatojë masat biologjike të mbrojtjes së kulturave ndaj

dëmtuesve, të tilla si: kujdesi për ruajtjen e “grabitqarëve” të dëmtuesve, përdorimi i feromoneve, përdorimi i biopesticideve me bazë biologjike nga vajrat bimorë, përdorimi i sterilizantëve etj.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë zbatimit të masave të kontrollit biologjik të kulturave drufrutore nga dëmtuesit.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të masave të kontrollit biologjik të kulturave drufrutore nga dëmtuesit.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 3 Nxënësi/ja vendos qafore në pemët frutore për kapjen e dëmtuesve.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë vendosjes së qaforeve për kapjen e dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për vendosjen e qaforeve për kapjen e dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për vendosjen e qaforeve për kapjen e dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të vendosë qaforet për kapjen e insekteve dëmtues të kulturave drufrutore sipas teknikave përkatëse.
- të monitorojë herë pas here kapjen e dëmtuesve dhe ti largojë nga parcela drufrutore.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë vendosjes së qaforeve për kapjen e dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vendosjes së qaforeve për kapjen e dëmtuesve të kulturave drufrutore.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 4 Nxënësi/ja vendos kurthe dhe letra ngjitëse për kapjen e dëmtuesve në pemtore.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:
- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë vendosjes së kurtheve dhe letrave ngjitëse për kapjen e dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për vendosjen e kurtheve dhe letrave ngjitëse për kapjen e dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe

mjeteve të punës për vendosjen e kurtheve dhe letrave ngjitëse për kapjen e dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të vendosë kurthet për kapjen e insekteve dëmtues të kulturave drufrutore sipas teknikave përkatëse.
- të vendosë letra ngjitëse për kapjen e insekteve dëmtues të k drufrutore sipas teknikave përkatëse.
- të monitorojë herë pas here kapjen e dëmtuesve dhe ti largojë nga parcela drufrutore.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë vendosjes së kurtheve dhe letrave ngjitëse për kapjen e dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vendosjes së vendosjes së kurtheve dhe letrave ngjitëse për kapjen e dëmtuesve të kulturave drufrutore.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 5 Nxënësi/ja vendos ferromone për kontrollin biologjik të kulturave drufrutore nga dëmtuesit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:
- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë vendosjes së ferromoneve për kontrollin biologjik të dëmtuesve.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për vendosjen e ferromoneve për kontrollin biologjik të dëmtuesve.
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për vendosjen e ferromoneve për kontrollin biologjik të dëmtuesve.
- të vendosë ferromonet për çorientimin e insekteve dëmtues të kulturave drufrutore sipas teknikave përkatëse.
- të monitorojë herë pas here popullatat e dëmtuesve në parcelën drufrutore.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë vendosjes së ferromoneve për kontrollin biologjik të dëmtuesve.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë vendosjes së ferromoneve për kontrollin biologjik të dëmtuesve.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 6 Nxënësi/ja bën trajtime me biopesticide për kontrollin biologjik të kulturave drufrutore nga dëmtuesit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jetë i aftë:
- të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë trajtimeve me biopesticide për kontrollin biologjik të

dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për trajtimin me biopesticide për kontrollin biologjik të dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për trajtimin me biopesticide për kontrollin biologjik të dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të të bëjë trajtimin me biopesticide për kontrollin biologjik të dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të monitorojë popullatat e dëmtuesve pas trajtimit me biopesticide në parcelën drufrutore.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë trajtimin me biopesticide për kontrollin biologjik të dëmtuesve të kulturave drufrutore.
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimit me biopesticide për kontrollin biologjik të dëmtuesve të kulturave drufrutore.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RN 7 Nxënësi/ja kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për për kontrollin biologjik të kulturave drufrutore nga dëmtuesit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi/ja duhet të jenë të aftë:
- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të përgatisë preventivin e shpenzimeve që duhen gjatë kontrollit biologjik të mbrojtjes së kulturave drufrutore nga dëmtuesit.
- të njehsojë kostot e kontrollit biologjik të mbrojtjes së kulturave drufrutore nga dëmtuesit, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport dhe makineri), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë detyrimet fiskale të kontrollit biologjik të mbrojtjes së kulturave drufrutore nga dëmtuesit, sipas formularëve përkatës.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për kontrollit biologjik të mbrojtjes së kulturave drufrutore nga dëmtuesit.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e shkollës ose në pemtoret e vreshtat përkatës.<br>– Mësimdhënësi i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të kontrollit biologjik të mbrojtjes së kulturave drufrutore nga dëmtuesit, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me kontrollin bologjik të dëmtuesve të kulturave |

| | |
|---|---|
| | drufrutore.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kontrollin biologjik fushor dhe monitorimin, masat e kontrollit biologjik, vendosjen e rrjetave, qaforeve, kurtheve, letrave ngjitëse, trajtimeve me biopesticide etj.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta për kontrollin biologjik të mbrojtjes së kulturave drufrutore nga dëmtuesit<br>– Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për kontrollin biologjik të mbrojtjes së kulturave drufrutore nga dëmtuesit.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë kontrollit biologjik të mbrojtjes së kulturave drufrutore nga dëmtuesit.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të kontrollit biologjik fushor dhe monitorimit, masave të kontrollit biologjik, vendosjes së rrjetave, qaforeve, kurtheve, letrave ngjitëse, trajtimeve me biopesticide etj.si dhe llogaritjet e thjeshta ekonomike për kontrollin biologjik të mbrojtjes së kulturave drufrutore nga dëmtuesit.<br>– Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Rrjeta kapëse insektesh<br>– Qafore për kapjen e insekteve<br>– Kurthe për insekte<br>– Ferromone<br>– Biopesticide<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e kontrollit biologjik të dëmtuesve në pemtore e vreshta (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## XI. Programi orientues i provimeve përfundimtare të nivelit.

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional ”Frutikulturë”, Niveli III i KSHK, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë profil mësimor, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e këtij niveli, të cilat do të shërbejnë si bazë për të konceptuar provimet teorike dhe praktike përkatëse.
Ky program i ndihmon nxënësit të përqëndrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësuesit për organizimin e punës në përgatitjen për kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.
Për drejtuesit e shkollave profesionale, këto programe krijojnë mundësinë për planifikimin dhe realizimin e Provimeve Përfundimtare në nivel shkolle.
Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t'i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.
Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare të niveleve, është e rëndësishme që paraprakisht mësuesit/instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste teorike apo praktike, të cilat mund t'i hartojnë vetë, duke përdorur instrumente vlerësimi në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, kriteret e vlerësimit të përcaktuara në modulet përkatëse si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.
Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

### A) Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në kualifikimin profesional ”Frutikulturë”, është hartuar duke u mbështetur në temat më të rëndësishme të programeve të lëndëve profesionale më përfaqësuese dhe më thelbësore, të cilat përbëjnë 30-35% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.
**Lëndët profesionale** të përzgjedhura për t`u përfshirë në provimin e teorisë profesionale dhe temat e përzgjedhura, janë si më poshtë.

**Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues:**

| Nr. | Lënda | Vëllimi i orëve për lëndën | Peshat në % |
|---|---|---|---|
| 1 | Frutikulturë | 46 | 60 |
| 2 | Përpunimi i frutave dhe rrushit | 15 | 19 |
| 3 | Teknologjitë e prodhimit biologjik në frutikulturë | 16 | 21 |
| | **TOTALI** | **77** | **100%** |

**Temat sipas lëndëve janë:**

Temat nga lënda “Frutikulturë” , kl. 12 : **46 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 6** | Teknologjitë e kultivimit të pemëtoreve | 10 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 7** | Teknologjitë e kultivimit të vreshtave | 6 orë |
| **Tema 10** | Shërbimet agroteknike në pemëtore e vreshta | 4 orë |
| **Tema 11** | Teknologjia e kultivimit të ullirit | 4 orë |
| **Tema 12** | Shërbimet agroteknike te ulliri | 10 orë |
| **Tema 14** | Shërbimet agroteknike te agrumet | 10 orë |
| **Tema 17** | Vjelja dhe teknologjitë e pasvjeljes së frutave | 2 orë |

Temat nga lënda "Përpunimi i frutave dhe rrushit" , kl. 12 : **15 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 3** | Përpunimi i frutave të freskëta për reçel, marmalatë dhe prevede. | 5 orë |
| **Tema 4** | Përpunimi i frutave të thata. | 3 orë |
| **Tema 6** | Përpunimi i agrumeve. | 3 orë |
| **Tema 7** | Përpunimi i ullirit. | 4 orë |

Temat nga lënda "Teknologjitë e prodhimit biologjik në frutikulturë" , kl. 12 : **16 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 2** | Normat teknike për prodhimin biologjik në frutikulturë | 3 orë |
| **Tema 3** | Metodat dhe teknikat e analizimit të cilësive biologjike të tokës | 2 orë |
| **Tema 4** | Llojet e plehrave, plehrat organike dhe minerale/shtuesit e lejuar në bujqësinë biologjike në frutikulturë | 3 orë |
| **Tema 5** | Tipet e punimeve të tokës dhe teknikat e punimeve minimale | 3 orë |
| **Tema 8** | Normat teknike të shërbimeve agroteknike në frutikulturën biologjike | 3 orë |
| **Tema 13** | Llojet e ambalazheve ekologjike, teknikat e ambalazhimit dhe ruajtjes së produkteve frutore biologjike | 2 orë |

**Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:**

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 (një presje pesë) dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i drejtimit/profilit të nivelit përkatës. Për hartimin e testit, komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve e përgatitur nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet, për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 20 njësi testi me një total prej 40 pikë. Nga këto, 10 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtetë e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.) Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

**Model i shpërndarjes së pikëve për pyetje të niveleve të ndryshme në test**

| **Niveli I (i ulët)** | **Niveli II (mesatar)** | **Niveli III (i lartë)** |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/ identifikuar dhe për të përshkruar... | Aftësia për të zbatuar/argumentuar/ shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar... | Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime... |

**Tabela 2: Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve**

| Nr. | Lënda | Peshat e lëndëve në % | Pikët për çdo lëndë | Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **Niveli I 40% e pikëve** | **Niveli II 40% e pikëve** | **Niveli III 20% e pikëve** |
| 1 | Frutikulturë | 60 | 24 | 10 | 10 | 4 |
| 2 | Përpunimi i frutave dhe rrushit | 19 | 8 | 3 | 3 | 2 |
| 3 | Teknologjia e prodhimit biologjik në frutikulturë | 21 | 8 | 3 | 3 | 2 |
| | **TOTALI** | **100%** | **40 pikë** | **16 pikë** | **16 pikë** | **8 pikë** |

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Për shembull: njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundrejt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuar marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrohen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.
Së fundi, skema e vendosjes së notës kundrejt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit me nota:

| Pikët e fituara | Notat |
|---|---|
| **0 - 10** | **4** |
| **11 - 15** | **5** |
| **16 - 20** | **6** |
| **21 – 25** | **7** |
| **26 - 30** | **8** |
| **31 - 35** | **9** |
| **36 - 40** | **10** |

**B) Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar**

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional ”Frutikulturë” është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

**Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit**, detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

| Nr | Kompetencat profesionale | Detyrat e punës | Pikët |
|---|---|---|---|
| 1. | Të prodhojë fidanë të shartuar të kulturave drufrutore/hardhisë | **Detyra 1-** Realizimi i një prej proceseve të **p**rodhimit të fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore/hardhisë: sigurimi i copave për nënshartesa, përgatitja e nënshartesës dhe mbishartesës, shartimi me syth, me kalem, nën lëvore, me koopulim në tavolinë, shtratifikimi i shartesave. | 20 |
| 2. | Të kryejë përpunimin e frutave. | **Detyra 2** - Realizimi i një prej proceseve të përpunimit të frutave: për lëng, për komposto, për reçel, për marmalatë, për prevede. | 10 |
| 3. | Të kryejë shërbimet në agroteknike dhe vjeljen në pemëtore dhe vreshta | **Detyra 3** - Realizimi i një prej shërbimeve të agroteknike dhe vjeljen e pemëtore dhe vreshta: plehërimi, punimi, ujitja, krasitja, përgatitja e tretësirës për trajtim, trajtimi i pemëve në pemëtore me PMB, vjelja sipas kulturave rajonale. | 20 |
| 4. | Të realizojë shartimin në vend të kulturave drufrutore. | **Detyra 4** - Realizimi i një prej shartimeve në vend i kulturave drufrutore: shartimi me kalem me çarje të plotë, shartimi me kalem nën lëvore, shartimi me koopulim, me hinkë. | 20 |
| 5. | Të realizojë krasitjen e kulturave drufrutore/ hardhisë | **Detyra 5** - Realizimi i një prej krasitjeve të kulturave drufrutore/hardhisë: krasitje të formave të ndryshme në pemët frutore**,** formon kurorën në formë kupore, kryen krasitje dimërore, krasitje të shkurtra dhe të gjata te hardhia, të formës së përzier te hardhia, kryen krasitje të gjelbëra). | 20 |
| 6 | Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të produkteve të kulturave drufrutore. | **Detyra 6 -** Realizimi i një prej llogaritjeve të thjeshta ekonomike të produkteve të kulturave drufrutore (llogaritjen e preventivit të shpenzimeve, llogaritjen e kostos për njësi, llogaritjen e çmimit për njësi, plotëson faturën e shitjes së produktit të realizuar në detyrat e mësipërme). | 10 |
| **Shuma** | | | **100** |

**Shënime:**

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në "***detyra pune***", në bazën prodhuese të shkollës, fidanishte të kulturave drufrutore, ose mjedise të shkollës të përshtatura dhe të pajisura me mjetet përkatëse.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 (tri) orë, në përputhje kjo me Udhëzimin nr. 15. Datë 26.04.2019 "Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në arsimin dhe formimin profesional", në fuqi.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t'i lihet hapësirë për vlerësime edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.

- Është ***e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme*** që për çdo detyrë, që në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësuesit/instruktorët (organizatorët e provimit) t'i kushtohet vëmendje ***"përcaktimit dhe zbatimit të rregullave të sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit"*** gjatë gjithë kryerjes së detyrës për çdo nxënës**.**
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërish të përfshira në vlerësim.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit, mjeteve dhe pajisjeve të punës, etj.
- Gjithashtu për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe pastrimi i vendit, i mjeteve dhe pajisjeve të punës pasi nxënësi ka realizuar dhe përfunduar detyrën.
- Për realizimin e detyrave, nxënësve duhet t'u sigurohen mjete, pajisjet si dhe materialet për realizimin e tyre.
- Nxënësit duhet të realizojnë të gjitha etapat për realizimin e detyrave.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme si dhe komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi ndërmjet njëri tjetrit etj.
- Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për çdo detyrë.
- Komisioni i provimit për çdo detyrë parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërën prej tyre. Komisioni i provimit duhet të përgatitë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.
- Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit.

Udhëzime për realizimin **e Detyrës 1 :** Nxënësi kryen procese pune për prodhimin e fidanëve të shartuar të kulturave drufrutore/hardhisë.
Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës, fidanishte të kulturave drufrutore, ose mjedise të shkollës të përshtatura dhe të pajisura me mjetet përkatëse.
Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me prodhimin e fidanëve të shartuar: sigurimi i copave për nënshartesa, përgatitja e nënshartesës dhe mbishartesës, shartimi me syth, me kalem, nën lëvore, me koopulim në tavolinë, shtratifikimi i shartesave.
Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të punës që lidhen me prodhimin e fidanëve të shartuar: sigurimin e copave për nënshartesa, përgatitja e nënshartesës dhe mbishartesës, shartimi me syth, me kalem, nën lëvore, me koopulim në tavolinë, shtratifikimi i shartesave dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.
Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.
Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale, copa ose sharmenda hardhie, material ngjitës, sytha, lidhëse, qese etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale.
Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin **e Detyrës 2.** Nxënësi kryen procese të ndryshme përpunimi të thjeshtë të frutave.
Kjo detyrë do të realizohet në repartin e përpunimit të frutave ose në mjedise të shkollës të përshtatur dhe të pajisur me mjetet përkatëse.
Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me përpunimin e frutave: për lëng, për komposto, për reçel, për marmalatë, për prevede.
Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë procese përpunimi të frutave: për lëng, për komposto, për reçel, për marmalatë, për prevede sipas kulturave rajonale dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.
Në fund të procesit të përpunimit të frutave nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve të përpunimit të frutave.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale ambalazhuese sipas llojit të përpunimit.

Nxënësi angazhohet në veprimtari praktike konkrete të tilla si: përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës, higjienizimi i vendit dhe mjeteve të punës dhe kryen njërin prej përpunimeve.
Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin **e Detyrës 3,** Nxënësi kryen shërbimet në kulturat drufrutore në prodhim.
Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës apo në fermat reale afër shkollës.
Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë procese pune që lidhen me shërbimet në kulturat drufrutore si: punimi i tokës, plehërimi, ujitje, krasitje, procese pune përgatitore për përgatitjen e tretësirës për trajtim, spërkatjen e bimëve të infektuara në pemëtore me preparate kimike të lëngshme ose pluhur dhe vjeljen.
Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e proceseve të shërbimeve në kulturat drufrutore si: punimi i tokës, plehërimi, ujitje, krasitje, përgatitja e tretësirës për trajtim, spërkatjen e bimëve të infektuara në pemëtore me preparate kimike të lëngshme ose pluhur, vjeljen, si dhe vendosjen e tabelave paralajmëruese për rezikun nga helmimi dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të punës të shërbimeve në drufrutoret nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale si plehëra organike dhe minerale, pesticide, tub uji etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin **e Detyrës 4 :** Nxënësi kryen sipas etapave shartimin në vend të kulturave drufrutore me kalema me çarje të plotë, me syth, me koopulim, me hinkë.
Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës apo në fermat reale afër shkollës.
Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë etapat e shartimit si dhe mënyrat e shartimit të kulturave drufrutore.
Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e shartimit në vend të kulturave drufrutore: kryen shartim me kalema, me syth, me koopulim, me hinkë dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.
Në fund të procesit të prodhimit nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.
Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale si material ngjitës, lidhëse shartmi, rafije, parafinë etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin **e Detyrës 5:** Nxënësi kryen krasitjen e kuturave drufrutore/ hardhisë.
Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e bazës prodhuese të shkollës ose në fermat reale afër shkollës.
Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë forma të ndryshme të krasitjeve të kulturave drufrutore (formë kupore, kupore e përmirësuar, kupore shkurore, palmet), format e krasitjes së hardhisë (krasitje të shkurtra, të gjata, të formës së përzier si dhe kryen operacione të gjelbra tek hardhia) etj.
Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë etapat e krasitjeve të kulturave drufrutore si: formë kupore, kupore përmirësuar, kupore shkurore, palmet si dhe krasitje të hardhisë si: krasitje të

shkurtra, të gjata, të formës së përzier, si dhe kryen operacione të gjelbra dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.
Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Materiale lidhëse, qese etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike.

Udhëzime për realizimin **e Detyrës 6.** Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të produktit të kulturave drufrutore.

Kjo detyrë do të realizohet në mjediset e firmës ushtrimore/biznese reale të profilit përkatës ose mjedise të shkollës të përshtatura dhe të pajisura me mjetet përkatëse. Detyra do të kryhet në mënyrë individuale nga çdo nxënës. Komisioni i provimit do të përgatisë paraprakisht disa teza, ku secila prej tyre do të përmbajë situata të ndryshme të llogaritjes së preventivit të shpenzimeve, të llogaritjes së kostos për njësi, çmimit për njësi prodhimi për produktin të realizuar në detyrat e mësipërme. Krahas llogaritjeve ekonomike, nxënësi duhet të plotësojë edhe faturën e shitjes së produktit. Në vijim duhet të organizohet një lojë me role në një situatë simulimi të shitjes së produkteve të përgaditura në detyrat e mësipërme.
Nxënësi angazhohet në veprimtari praktike konkrete të tilla si: përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës, llogaritje të tjeshta ekonomike si dhe të plotësimit të dokumentacionit përkatës. Për realizimin e kësaj detyre, instruktori, komisioni duhet të sigurojë, mjediset, paisjet dhe materialet e mëposhtme: mjedise të firmës ushtrimore/biznes, kompjuter, fotokopje, shërbime interneti, programe kompjuterike, materiale udhëzuese të shkruara, pajisje kancelarie, makina llogaritëse dore, manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos, modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal, etj. Komisioni i provimit të përgatisë paraprakisht instrumentet e vlerësimit me hapat/etapat e procesit. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit. Vlerësimi i kësaj detyre bëhet me pikë në bazë të përmbushjes së gjithë proceseve të përfshira në tezën përkatëse të çdo nxënësi, si dhe në bazë të instrumentit të vlerësimit përkatës. Komisioni i provimit përgatit paraprakisht instrumentin e vlerësimit, i cili do të jetë një listë kontrolli dhe lista e kritereve të vlerësimit me tolerancën përkatëse për cilësinë e shërbimit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe.

Secili nga postet e punës së lartpërmendur të ketë listë vlerësimi më vehte dhe në fund të realizimit të detyrave të parashikuara, të bëhet tabela përmbledhëse e pikëve dhe të hidhet nota përkatëse.
Nxënësit do të vlerësohen për realizimin e detyrave sipas listës së kontrollit.